

TRANSCRIPT - Kosova e Bukur

[ANDRIJANA ZIVANOVIC]

Ja pra, ky është vendi ynë.

[NARRATOR]

Jemi në Qendrën Kulturore të Zubin Potokut me drejtoreshën, Andrijana. Ajo po na tregon sallën e kinemasë e cila është renovuar me fonde nga Bashkimi Evropian.

[ANDRIJANA ZIVANOVIC]

Dyshemeja dhe bina janë renovuar; i kanë bërë të gjitha këto, e kanë rregulluar tavanin, i kanë ngjyrosur muret. Ja, këtu e kanë ndërruar dyshejen.

[NARRATOR]

Me këtë renovim, qendra kulturore duket më tërheqëse se më parë. Por ajo gjithashtu ofron shërbim më të mirë për komunitetin e Zubin Potokut. Renovimi i qendrës është pjesë e projektit BE-Kosova e Bukur. I financuar nga Bashkimi Evropian dhe implementuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim apo IOM ky projekt pesë milionësh synon ta zbkurojë Kosovën, renovojë ndërtesa publike dhe mbrojë trashëgiminë kulturore, duke krijuar mundësi punësimi. Lendita Gashi, nga Bashkimi Evropian, punon në projektin BE-Kosova e Bukur:

[LENDITA GASHI]

Programi përfshin konkurs për propozime për të gjitha komunat. Ne i ftojmë ata të propozojnë projekte që fokusohen në disa fusha të intervenimit. Këto fusha duhet të ndërlidhen me renovimin e ndërtesave publike: mund të jetë trashëgimia kulturore; mund të jenë objekte sporti për të rinjtë; hapësira gjelbëruese, rehabilitim i shtratit të lumit e kështu me radhë. Pastaj e bëjmë përzgjedhjen e projekteve. Në fazën e parë, i kemi implementuar 46 projekte, në komuna të ndryshme të Kosovës. Pjesë e këtyre 46 projekteve ishin renovime të shkollave, për shembull oborre të shkollave, ndërtimi i objekteve sportive për fëmijë, si dhe ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Kllokot. Kemi bërë shumë parqe, shteg për ecje për në kalanë e Novo Bërdos pasi që lidhet me turizëm por edhe me trashëgimi kulturore. Dhe të gjitha këto projekte e kanë një element kyç që është punësimin afatgjatë të personave të papunë. Na është dashur t i përzgjedhim këto projekte që kemi menduar se do të kenë ndikim më të madh në përmirësimin e kushteve jetësore të qytetarëve të komunave, por në të njëjtën kohë, ta adresojmë edhe elementin e punësimit.

[NARRATOR]

Sipas të dhënave të OKB-së, shkalla e papunësisë në Kosovë është 35% kurse më e lartë është për grad he të rinjë. Alessia Schiavon është menaxherja e projektit BE-Kosova e Bukur nga IOM:

[ALESSIA SCHIAVON]

Shkalla e papunësisë afatgjate në Kosovë është një sfidë shumë e madhe dhe po ashtu është një prej faktorëve kryesor që e shtyjnë popullsinë e Kosovës të migrojë jashtë sidomos përmes kanaleve jo të rregullta. Për këtë arsye programi fokusohet te personat e papunësuar për një kohë të gjatë të regjistruar në qendrat lokale të punësimit. Fokus specifik janë kryefamiljarët që janë aktualisht të papunë dhe nuk mund të mbajnë familjet e tyre me fëmijë. Dhe gjithashtu, një fokus i veçantë është në kategoritë e ndieshmë, rinia, personat me nevoja

të veçanta, gratë, të kthyerit dhe personat nga grupet minoritare. 1,905 vende të reja pune janë krijuar përmes implementimit të këtyre 46 projekteve. Në mesin e tyre, 78 kanë qenë për gra, 76 për persona me nevoja të veçanta, 336 për minoritete dhe 260 për të rinjë.

[NARRATOR]

Projekti BE-Kosova e Bukur ka kërkuar që kompanitë e kontraktuara, që e kanë kryer punën, të punësojnë persona nga qendrat e punësimit. Dhe disa nga projektet kanë rezultuar në punësim afatgjatë, edhe pas përfundimit të ndërtimit apo renovimit fillestar. Një rast i tillë ishte në Kllokot, ku është ndërtuar çerdhja e fëmijëve, por edhe në Zubin Potok. Aleksandar Ratković e ka udhëhequr renovimin e qendrës kulturore atje:

[ALEKSANDAR RATKOVIC]

Disa njerëz që kanë punuar në Qendrën Kulturore ende punojnë edhe sot me ne në disa projekte tjera. Ata që kanë shfaqur njohuri për punën që e bëjnë. Sigurisht, 5 apo 6 të rinjë e kanë vazhduar punën me ne në projekte tjera.

[NARRATOR]

Inkurajuar nga sukcesi fillestar, BE-ja ka vendosur të lansojë fazën e dytë të projektit që do të zgjasë deri më 2016. 1,300 vende të reja pune pritet të krijohen, dhe Kosova do të bëhet edhe më e bukur.